




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM  
Opstinska Kancelarija za Zajednice i Povratak  
Municipality Office for Communities and Returns

Data/Datum/Date	27.03.2023
Nr/Br/No	02/2/201
Përmes/Preko/Through	
Nga/Od/From	Ibrahim Demiri-shëf i ZKKK-së
Lënda/Predmet/Subjekt	Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për projektet e OJQ-ve që janë në interes të komuniteteve joshumicë.

Në bazë të nenit 12 të Rregullorës MFPT Nr.04.2017 mbi kriteret, standardet, dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), e Komunës së Shtimes, u bën thirrje të gjitha organizatave joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që i kontribuojnë komuniteteve joshumicë.
2. OJQ-të, në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projekte/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:
  2. Të gjitha OJQ-të, në Komunën e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e mbështetjes së arsimimit dhe edukimit të fëmijëve dhe të të rriturve të komuniteteve.
  3. Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë me një projekt që i kontribuon vetëdijësimit të prindërve lidhur me arsimimin e komuniteteve ashkali dhe rom, në komunën e Shtimes..
  4. Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë me një projekt që i kontribuon aktiviteteve kulturore rinore e që mund t'i realizojnë për shënimin e datave të veçanta, për komunitetet.
5. Vlera totale e planifikuar, e thirrjes është: 3000 €
6. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë, nga data 27.03.2023 deri më 14.04.2023
6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti 2 projekte në kuadër të kësaj thirrjeje, por vetëm me një projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të thirrjes është deri në dhjetor të vitit 2023. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes publike.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Shtimes, së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e interesave të komuniteteve ashkali dhe rom.

OJQ-të duhet, po ashtu, të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë , të cilët së bashku me udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në uebfaqen e internetit të Komunës së Shtimes.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën:

Rruga "Tahir Sinani" Nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës (Objekti i Komunës-Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim ). Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në ZKKK.